

Instrumenti	Karakteristikat kryesore:	Kush mund të aplikojë?	Buxheti maksimal	Kohëzgjatja maksimale
Grantet e vogla për projekte	<ul style="list-style-type: none"> • Synojnë t'i mbështesin nismat e individëve, nismat e peregjistruara dhe organizatat joqeveritare për ndërhyrje më të përqendruara dhe afatshkurtra; • Aplikantëve u kërkohet të veprojnë në lokalitetet e tyre përkatëse; • Organizatat që kanë buxhet vjetor të qarkullimit mbi 25.000 EUR përjashtohen nga ky instrument; • Aplikantët garojnë midis të barabartëve dhe nuk vendosen në konkurrencë me OSHC-të e konsoliduara që kanë më shumë aftësi organizative për shkrimin e propozimeve; • Kanë për qëllim të japin rezultate konkrete brenda një afati të caktuar kohor; • Kërkojnë qasje të qarta në përfshirjen e qytetarëve dhe të grupeve të synuara në ndërhyrje; 	<ul style="list-style-type: none"> • Individët • Nismat e peregjistruara • OJQ-të 	10.000 EUR	12 muaj
Grantet e mesme për projekte	<ul style="list-style-type: none"> • Synojnë të mbështesin ndërhyrje nga ato mesatare deri te ndërhyrjet e mëdha; • OJQ-të e synuara janë ato që kanë kapacitete të mjaftueshme për të zbatuar projekte që pritet të kenë ndikim në nivelin kombëtar ose procese më sistematike në nivel lokal ose kombëtar; • Kanë për qëllim të japin rezultate konkrete brenda një afati të caktuar kohor; • Kërkojnë qasje të qarta në përfshirjen e qytetarëve dhe të grupeve të synuara në ndërhyrje; 	<ul style="list-style-type: none"> • OJQ-të 	50.000 EUR	24 muaj
Grantet urgjente	<ul style="list-style-type: none"> • Synojnë të mbështesin ndërhyrje urgjente; • Janë të menduara vetëm për ato raste në të cilat nevojitet reagim i shpejtë nga nismat e shoqërisë civile dhe nuk mund të kenë kohë të mjaftueshme për të reaguar përmes procedurave standarde të aplikimit; • I japin përparësi domosdoshmërisë së reagimit dhe urgjencës së çështjes; • Kanë procedurë e thjeshtë të aplikimit; • Kanë vendimmarrje të shpejtë; • Kërkojnë rezultate afatshkurtra e të përqendruara; 	<ul style="list-style-type: none"> • Individët • Nismat e peregjistruara • OJQ-të 	5.000 EUR	N/A
Grantet institucionale	<ul style="list-style-type: none"> • Synojnë të mbështesin zbatimin e strategjive të organizatave dhe, paralelisht me forcimin e qeverisjes së brendshme dhe aftësive organizative, organizatat e mbështetura të bëhen zëri i qytetarëve në temat që ato mbulojnë; • Kanë për qëllim t'i mbështesin organizatat që janë përfaqësuese të ndryshimit dhe që veprojnë e kontribuojnë në zhvillimet kryesore shoqërore në fushat e tyre të ekspertizës; • U mundësojnë organizatave t'i adresojnë çështjet e identifikuar në mënyrë të vazhdueshme dhe kurdo që ato paraqiten, pa pasur nevojë që të planifikohen si në rastin e granteve për projekte; • Jo më shumë se 15% e buxhetit të përgjithshëm të propozuar mund të ndahet për zhvillim organizativ; • Kërkojnë qasje të qarta në përfshirjen e qytetarëve dhe të grupeve të synuara në punën e organizatës; 	<ul style="list-style-type: none"> • OJQ-të 	40.000 EUR/për vit ose Maksimumi 120.000 EUR për grant.	24-36 muaj
Grantet për zhvillim organizativ	<ul style="list-style-type: none"> • Përqendrohen në mbështetjen e ndërtimit të kapaciteteve të organizatave (stafit, zhvillimit të sistemeve të brendshme organizative, dokumenteve të brendshme etj.); • Mund të financohet një aktivitet i vetëm ose një tërësi aktivitësh; • U mundësojnë organizatave të aplikojnë për zhvillimin e cilitdo program brenda organizatës; • Kërkojnë qasje të qarta në përfshirjen e qytetarëve dhe të grupeve të synuara në punën e organizatës; 	<ul style="list-style-type: none"> • OJQ-të 	15.000 EUR	24 muaj
Çmimi për Demokraci	<ul style="list-style-type: none"> • Ka për qëllim të vlerësojë kontributet e individëve, grupeve të qytetarëve dhe të organizatave në fusha të ndryshme, që janë rezultat i mobilizimit të komunitetit dhe angazhimit të qytetarëve, ideve të reja, guximit intelektual ose arritjeve, dhe që kanë kontribuar në demokratizimin e shoqërisë kosovare përmes punës dhe përkushtim të tyre; 	<ul style="list-style-type: none"> • Individët • Nismat e peregjistruara • OJQ-të 	5.000 EUR	Çmim vjetor